

**L I G J**  
**Nr.8626, datë 22.6.2000**

**STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pikë 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Neni 1

Nga ky ligj përfitojnë të gjithë invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga mosha, koha, vendndodhja e aksidentit dhe çasti i sigurimit.

Neni 2

Në kuptimin e këtij ligji:

- “Paraplegjik” nënkupton çdo person që vuan nga paraliza e dy anësive të poshtme si pasojë e dëmtimit të palcës kurizore nga shkaqe të ndryshme.
- “Tetraplegjik” nënkupton çdo person, që vuan nga paraliza e katër anësive si pasojë e dëmtimit të palcës kurizore nga shkaqe të ndryshme dhe i klasifikuar si i tillë me vendimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.

Neni 3

Shteti krijon kushte për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëloj si të tjerët, duke siguruar përtakohesësi e nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, kushte banimi, jetesë e punë të përshtatshme, si dhe u krijon mundësi normale për kurim, arsimim, veprimit, çlodhëse, argëtuese dhe sportive.

Ministria e Shëndetësisë parashikon çdo vit në buxhetin e shpenzimeve të saj fondet e nevojshme për kontrollë periodike vjetore nga mjekë të specializuar për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Neni 4

Shteti mbron të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga të gjithë llojet e shfrytëzimit, të diskriminimit, të abuzimit dhe të fyerjes.

Neni 5

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi.

Kriteret e dhënies së dëshmisi dhe forma e saj përcaktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe të Shërbimeve Sociale.

Neni 6

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë përfjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta. Në rastet kur ata vetëpunësohen si persona fizikë dhe janë subjekte të tatimit mbi biznesin e vogël, kuota e tatimit fiks është sa gjysma e asaj të përcaktuar në nenin 3 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

## Neni 7

Personat juridikë, shtetërorë ose privatë që punësojnë të sëmurë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, përveç kritereve të përcaktuara në ligjin nr.7955, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, përfitojnë për çdo vit kalendarik ulje tatimi mbi fitimin, të barabartë në përqindjen e fuqisë punëtore të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Ministria e Financave nxjerr aktet nënligjore përkatëse në bazë të këtij ligji.

## Neni 8

Shteti favorizon arsimimin e të sëmurëve paraplegjikë në shkollat e larta të sistemit shtetëror. Këshilli i Ministrave merr masa dhe përcakton fonde për ngritjen e shkollave dhe të institucioneve për arsimimin, edukimin dhe rehabilitimin e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

## Neni 9

Shteti i përjashton të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga pagesat për sigurimin shëndetësor dhe u jep atyre të drejtën e përfitimit falas të barnave për sëmundjen, pasojë e invaliditetit.

## Neni 10

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë që janë në gjendje të rëndë dhe në pamundësi për t'u paraqitur në institucionet shtetërore, përfitojnë shërbimin në banesë nga mjeku i familjes dhe mjeku specialist për ato procedura mjekësore që mund të kryhen në mënyrë ambulatore dhe në kushte shtëpie. Ministria e Shëndetësisë nxjerr aktet nënligjore përkatëse për këtë qëllim.

## Neni 11

Udhëtimi urban i të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, bashkë me shoqërueshin e tyre, bëhet falas në mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat, ndërsa udhëtimi interurban rimbursohet nga shteti në masën 50 për qind të vlerës.

## Neni 12

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë pajisen me telefon. Ata paguajnë tarifat telefonike të nivelit të parë, favorizuar për popullsinë e përcaktuar në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe përjashtohen nga tarifat e tjera. Diferencat paguhen nga shteti.

## Neni 13

Shteti financon veprimtaritë e organizuara nga shoqatat e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë sipas burimeve financiare të planifikuar për këtë qëllim në buxhetin e shtetit.

## Neni 14

Shteti merr përsipër të vërë në dispozicion dhe të japë falas mqedise për zhvillimin e veprimtarisë së shoqatës të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

## Neni 15

Invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga të ardhurat që përfitojnë nga shteti, marrin një shtesë në të holla për shkak të paralizës së tyre, në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Kjo shtesë nuk llogaritet në të ardhurat familjare për efekte të nivelit ekonomik. Invalidët kanë të drejtë për një pagesë, po në këtë masë, për kujdestarin e tyre, të zgjedhur sipas procedurave

ligjore.

#### Neni 16

Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe e Shërbimeve Sociale administron mjetet e përshtatura për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Kriteret përcaktohen me rregullore nga Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe e Shërbimeve Sociale.

Personat e sëmurë paraplegjikë dhe tetraplegjikë përjashtohen nga taksat doganore për mjete, të cilat ndihmojnë në integrimin e tyre në jetë, përfshirë këtu dhe autovetura të përshtatura për përdorim prej tyre.

#### Neni 17

Shteti merr përsipër trajtimin me përparësi me strehim, nëpërmjet kredive të dhëna me kushte lehtësuese për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

#### Neni 18

Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit përcakton tarifat e reduktuara të konsumit të energjisë elektrike për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

#### Neni 19

Ministria e Shëndetësisë merr masa që në spitalet e nivelit të dytë dhe të tretë të përshtaten dhe të pajisen një deri dy dhoma për shtrimin eventual të të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjik.

#### Neni 20

Në vende publike (aeroporte, stacione treni, stadiume, hotele etj.) krijohen mjetet përlëvizjen, qëndrimin dhe shërbimin për të sëmurët paraplegjikë sipas ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Statusi i invalidit”.

#### Neni 21

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të neneve 6, 9, 11, 12, 13, 14, 16, 17 dhe 19 të këtij ligji.

#### Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2670, datë 04.07.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**